



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Ekonomisë
Ministarstvo Ekonomije / Ministry of Economy

Në bazë të Ligjit Nr. 06/L – 114 për zyrtarët publikë, Neni 38 (1,2,3 dhe 4) dhe Rregullores (QRK) NR. 16/2020 për pranimin dhe karrierën në shërbimin civil të Republikës së Kosovë, Neni 40 Ministria e Ekonomisë shpall:

Konkurs

Lëvizje brenda kategorisë

Të drejtë për aplikim në këtë procedurë kanë vetëm nëpunësit civil ekzistues të së njëjtës kategori të punësuar në të njëjtin apo në një tjetër institucion të shërbimit civil.

Titulli i pozitës së punës	Zyrtar i lartë për shkathtësi profesionale dhe performancë energjetike
Klasa e pozitës	Profesional 1
Koeficienti/Paga	5.75
Nr. i kërkuar	1
Data e njoftimit	13/09/2023
Afati për aplikim	28/09/2023 - 05/10/2023
Institucioni	Ministria e Ekonomisë
Departamenti	Departamenti i Energjisë
Divizioni	
Vendi i punës	Prishtinë
Nr. i Referencës	RN00012485
Kodi	RPC0006038



1. Përshkrimi i përgjithshëm i punës

1. Mbështetja e zhvillimit të politikave për performancë energjetike;
2. Bashkëpunon me institucionet kompetente për performancë energjetike;
3. Përgatit raporte analitike për performancë energjetike;
4. Propozon masa/skema për rritjen e performancë energjetike;
5. Kryen detyra tjera me kërkesë të eprorit.

Kryen çdo detyrë tjetër në fushën e politikave të eficiencës së energjisë në përputhje me detyrat e parapara në planet e punës të miratuara në përputhje me ligjet, rregulloret, politikat dhe procedurat përkatëse, brenda afateve kohore të caktuara

2. Kushtet për lëvizjen brenda kategorisë dhe kërkesat e veçanta

- Të jetë nëpunës civilë i të njëjtës kategori për të cilën aplikon.
- Të jetë nëpunës civil i konfirmuar në detyrë në rastin e lëvizjes brenda kategorisë profesionale.
- Të mos jetë ndëshkuar me ndonjë masë disiplinore që nuk është shuar ende.
- Të jetë vlerësuar të paktën 'mire' për rezultatet në punë, të paktën gjatë dy viteve të fundit të vlerësimit.
- Në rastin e konkurimit për levizje brenda kategorisë profesionale të jetë vlerësuar të paktën mirë në vitin e fundit.

3. Kërkesat e përgjithshme formale

- **Arsimimi i kërkuar:** Diplomë/a e arsimit të lartë më së paku 3 vite të studimeve, drejtimi: Inxhinieri Energjetikës, Arkitekturës, Ndërtimtarisë, Makinerisë, Ekonomisë;
- **Kualifikime të posaçme formale:** Nuk ka.
- **Përvoja e punës e kërkuar:** Së paku dy (2) vite përvojë pune profesionale brenda sektorit të energjisë

4. Kërkesat (Njohuri, Aftësi dhe Cilësi) e përgjithshme të nevojshme

- Njohuri të thellë dhe të specializuara në fushën profesionale specifike;
- Nivel të lartë të njohurive profesionale ose teknike të fushës përkatëse dhe të kuptuarit e fushave që ndërlidhen me detyrat dhe përgjegjësit;
- Njohuri të gjera të fushës, të metodave kërkimore, që ndihmojnë në përgatitjen e raporteve bazike ose analitike;
- Aftësi të arsyetimit logjik dhe analizës;
- Aftësi për të bërë gjykime profesionale të pavarura dhe për të ushtruar diskrecion mbi çështjet dhe për të dhënë një kontribut të rëndësishëm në zhvillimin dhe zbatimin e politikave;
- Shkathtësi hulumtuese, analitike, vlerësuese dhe formulim të rekomandimeve dhe këshillave profesionale;
- Aftësi komunikimi dhe ndikim personal, përfshirë aftësi për të përfaqësuar.



5. Dokumentacioni që duhet paraqitur për aplikim

- Kopjet e diplomave të dhëna nga institucionet arsimore
- Kopjet e dëshmisë së punësimit
- Kopjet e dëshmisë së trajnimeve
- Kopje të vlerësimeve të punës për dy vitet e fundit
- Dokument që dëshmon se nuk keni ndonjë masë disiplinore që nuk është shuar ende

6. Data e daljes së rezultateve të vlerësimit paraprak

- Lista e kandidatëve të cilët plotësojnë kushtet për lëvizje brenda kategorisë do të shpallet më së largu deri më datën 12/10/2023, në portalin e rekrutimit elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>)

7. Data, vendi dhe ora ku do të zhvillohet intervista me gojë

- 19/10/2023 (data e përafërt), ora 10, Ministria e Ekonomisë Adresa: Sheshi Zahir Pajaziti nr.36, Prishtinë

8. Fusha e njohurive, aftësive dhe cilësive që do të vlerësohen në intervistën me gojë

- Njohuri substanciale për sektorin e efijencës së energjisë, si dhe aftësi në hartimin e planeve të veprimit, dokumenteve strategjike dhe programeve;
- Aftësi në formulimin e rekomandimeve dhe këshillave profesionale nga fusha e efijencës së energjisë;
- Njohuri të ligjeve dhe rregulloreve të aplikueshme;
- Aftësi të arsyetimit logjik dhe analizës;
- Aftësi për të mbajtur qëndrim profesional në situata të vështira dhe nën trysni të mëdha kohore;
- Shprehje të shkëlqyera komunikimi dhe koordinimi, si dhe aftësi për planifikimin e punës dhe udhëheqje të ekipit;
- Shprehje të mira ndërmjet personale me aftësi për të ndërvepruar dhe mbajtur marrëdhënie të efektshme dhe harmonike me kolegët dhe udhëheqësit;
- Shkathtësi kompjuterike të programeve (Word, Excel, Power Point, Access);
- Njohuri të gjuhës Angleze, e preferueshme .

9. Mënyra e vlerësimit të kandidatëve/aplikantëve

- Intervist

10. Mënyra e njoftimit dhe komunikimit me kandidatët

- Përmes email dhe portalit për rekrutim elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>)

11. Mënyra e aplikimit

- Përmes portalit për rekrutim elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>)



12. Data e shpalljes së rezultateve përfundimtare

- Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, fituesi do të shpallet përmes portalit për rekrutimi elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>). Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike.

Të dhëna shtesë:

Komunitetet joshumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në shërbimin civil të Kosovës, siç specifikohet në Ligj.

Komunitetet jo-shumicë dhe pjesëtarët e tyre, gjinia më pak e përfaqësuar dhe personat me aftësi të kufizuara inkurajohet të aplikojë për pozitat e shpallura.

Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen dhe aplikacionet e mangëta refuzohen

